

**Z. Koço Sokoli** ka vazhduar studimet e larta për Drejtësi në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin e Tiranës, të cilat i finalizoi në vitin 1990.

Karriera e tij profesionale ka filluar që në vitin 1995, duke mbajtur postin e Shefit të Departamentit Juridik në Drejtorinë e Përgjithshme e Policisë së Ndërtimit, detyrë të cilën e ka mbajtur deri në vitin 1997.

Prej vitit 1997 deri në vitin 2000, është angazhuar si inspektor në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Jashtë dhe Investimeve të Huaja, në Drejtorinë e Prokurimeve si dhe në Drejtorinë e Kontrollit të Institucioneve dhe Sh.a-ve.

Në vitin 2000 deri në vitin 2005, është transferuar në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm, në pozicionin e audituesit.

Nga viti 2005 e në vijim, Z. Sokoli është i punësuar në institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, ku ka qenë pjesë e disa departamenteve, më konkretisht mund të përmendim Departamentin e Kontrollit të Administratës së Lartë Publike; Drejtorinë Juridike, Metodologjisë dhe Kontrollit të Cilësisë; në Departamentin e Performancës si dhe aktualisht është pjesë e Departamentit Juridik në pozicionin e Kryeaudituesit.

Gjithashtu, gjatë periudhës së këtyre angazhimeve profesionale ka kryer në sërë trajnimesh brenda dhe jashtë vendit, të vlerësuara me çetifikatë, ku ndër to mund të përmendim: — “Drejtimit, Organizimit dhe Motivimit” nga Instituti i Menaxhimit dhe Administrimit Publik; — “Trajnim për Sistemin Fiskal” nga NIK në Poloni; — “Trajning of Internal Auditors in Audit on Administrativ Procedures” nga Banka Botërore në Poloni; — “Auditim i Brendshëm” nga Banka Botërore në Poloni; — “Hartim Legjislacioni” nga Departamenti i Administratës Publike; — “Audit i Brendshëm në Sektorin Publik” nga Ministria e Financës; — Kurs IT “IDEA 2004” nga OSBE; — “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë; — “Prokurimi me mjete elektronike” nga Agjencia e Prokurimit Publik.